



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I STREHIMIT  
KUÇOVË

4358  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Kuçovë, më 6.12.2019

**Lënda:** Njoftim mbi afatin e ankimimit, për vlerësimin e aplikantëve për përfitimin nga programet e strehimit social, banesa sociale me qera.

**Të Nderuar Aplikantë,**

Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Kuçovë Nr.53, datë 19.06.2019 “Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit në Bashkinë Kuçovë, në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë Nr.269 datë 23.09.2019 “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit në Bashkinë Kuçovë”, komisioni i Strehimit mori në shqyrtim dokumentacionet e dorëzuar nga aplikantet dhe sipas procesverbaleve përkatës u vlerësuan me pikë.

Numri i përcaktuar i apartamenteve për këtë program është 10, bazuar në vlerësimin e bërë 10 aplikantët e vlerësuar me më shumë pikë janë listuar si më poshtë sipas numrit rendor të aplikimit dhe listuar në rend zbritës .

Në zbatim të nenit 6 pika 7, të rregullores së miratuar për përbërjen e funksionimit të komisionit të strehimit ku në përfundim të procedurës së vlerësimit me pikë, zyra e strehimit njofton familjet dhe individët për vlerësimin e kryer nga komisioni i strehimit, duke publikuar atë në faqen zyrtare të Bashkisë Kuçovë, dhe duke e afishuar atë në vendet përkatëse.

Afati i ankimimit për familjet e individëve është 30 ditë kalendarike, nga data e njoftimit mbi vlerësimet e Komisionit të Strehimit.

**Nga sa më sipër Ju keni të drejtë që ankimimin Tuaj ta paraqisni deri me datë 06 janar 2020, pranë Bashkisë Kuçovë.**

**Duke Ju falenderuar,**

**Kryetari i Komisioni i Strehimit  
Miranda Shkëmbi**

*M. Shkëmbi*  
SS

